



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 74, datë 26.05.2016

MBI

**MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
TË JO-JETËS “EUROSIG” SH.A. NË SHOQËRINË E SIGURIMIT “INSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 48, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 4104/2, datë 17.05.2016, ka informuar Bordin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, se në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 23.03.2016 “Për miratimin e procedurës së tenderimit për shitjen e paketës së aksioneve (100 për qind), të zotëruara nga shteti në shoqërinë “INSIG” sh.a., Tiranë dhe shpalljen fitues të tenderit shoqërinë “EUROSIG” sh.a.”, shoqëria e sigurimit “EUROSIG” sh.a. ka kryer pagesën e plotë për blerjen 100% të aksioneve të shoqërisë së sigurimit “INSIG” sh.a.

Në zbatim të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe referuar pikës 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.06.2015 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të aksioneve të shoqërisë “INSIG” sh.a”, për procedurat e privatizimit të shoqërisë “INSIG” sh.a. dhe për kushtet e kontratës së shitjes me ofertuesin fitues, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike ka kërkuar dhe miratimet përkatëse nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 100%, të shoqërisë së sigurimit “EUROSIG” sh.a. në shoqërinë e sigurimit “INSIG” sh.a.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së shoqërisë së sigurimit “EUROSIG” sh.a., me Ministrinë e Financave.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI